



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MES

***CENTRUM DENTAL CLINIC SH.P.K
DHE
SINDIKATA E POLICISË TË KOSOVËS***

QËLLIMI

Centrum Dental Clinic SH.P.K dhe Sindikata e Policisë së Kosovës (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për bashkëpunim duke e konsideruar këtë bashkëpunim të domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve dentare në përputhje me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

FUSHËVEPRIMI

Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK) njih vlerën dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga **Centrum Dental Clinic SH.P.K.**

Centrum Dental Clinic SH.P.K njih përfitimet e angazhimit me **SPK** duke ofruar shërbimet dentare për anëtarët e saj.

PROGRAMI I ZBRITJES SË ANËTARËSISË - SPK

Të gjithë anëtarët e SPK-së pasi të dëshmojnë me ID kartelen e Policisë së Kosovës ju aplikohet zbritja 30% në të gjitha shërbimet dentare nga **Centrum Dental Clinic SH.P.K**, si dhe zbritja 50 % në rast të lëndimit në detyrë të zyrtarëve policor.ku rekomandohet shërbimi dentar. Këto zbritje aplikohen në **Centrum Dental Clinic SH.P.K**.

ANGAZHIMET E PALËVE

Palët do të angazhohen që:

1. Përgjegjësitë e **Sindikates së Policisë së Kosovës** : do ti udhezoi të gjithë anëtarët e saj për kryerjen e shërbimeve dentare , gjithashtu ti njoftoj dhe për zbritjet që janë ofruar nga **Centrum Dental Clinic SH.P.K**.
2. **SPK** do te inkurajoj anëtarët e saj qe të përdorin shërbimet dentare dhe do të promovojnë ndergjegjësimin për shërbimet e ofruara nga **Centrum Dental Clinic SH.P.K**
3. **SPK** do ti percjell tek anëtarësia e saj të gjitha njoftimet, fushatat dhe pakot e ndryshme që do ti dergohen nga **Centrum Dental Clinic SH.P.K**.
4. Përgjegjësitë e **Centrum Dental Clinic SH.P.K**: do ti ofroj mbështetjen dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me pyetjet e pacientëve nga **Sindikata e Policisë së Kosovës SPK**
5. **Centrum Dental Clinic SH.P.K**: do te trajtoj menjëherë çdo çështje ose shqetësim të ngritur nga anëtarësia e SPK-së përmes udhëheqësisë së saj në lidhje me planifikimin e kontrollave dhe shërbimeve dentare.

METODOLOGJIA E BASHKËPUNIMIT

1. Me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të ndërsjelltë , palët dakordohen që bashkëpunimin e përcaktuar të këtij memorandumit ta realizojnë përmes:
Takimeve të thirrura nga cilado palë në bazë të nevojës në mes të përfaqësuesve të **SPK**-se dhe përfaqësuesve të **Centrum Dental Clinic SH.P.K**
2. Për çfarëdo nevojë lidhur me praktikën e bashkëpunimit, palët në këtë marrëveshje do të bashkërendojnë veprimet e tyre me qëllim të arritjes së objektivave të shprehura në këtë marrëveshje.

MËNYRA E KOMUNIKIMIT

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'iu komunikojnë zyrtarëve të tyre për komunikim përmes shkresës zyrtare të autorizuar nga organi kompetent i palës.
2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejta si dhe përmes komunikimit elektronik. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.

KOHËZGJATJA DHE ZGJIDHJA E MEMORANDUMIT

1. Kjo marrëveshje fillon nga data 11.07.2025 dhe është e vlefshme për periudhën 2 vjeqare, deri me datën 11.07.2027
2. Palët mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e kësaj marreveshje me paralajmërimin paraprak me shkrim jo më larg se 30 ditë para shkëputjes.
3. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.
4. Palët bien dakord për format e përmirësimit të mangësive të evidentuara në mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjellët midis tyre.
5. Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me aprovim me shkrim të palëve.

HYRJA NE FUQI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
Shoqata Sindikale DRP-Gjakovë



The image shows a blue ink signature over a circular stamp. The stamp contains the text 'SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS' and 'SHOQATA SINDIKALE DRP - GJAKOVË' around a central emblem.

CENTRUM DENTAL CLINIC SH.P.K



The image shows a blue ink signature over a circular stamp. The stamp contains the text 'CENTRUM DENTAL CLINIC SH.P.K.' around a central emblem, with 'CENTRUM DENTAL CLINIC' and '812017798' below it, and 'GJAKOVË' at the bottom.

Datë; 11.07.2025